



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 292, Datë 26.12.2024**

**MBI**

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE LIDHUR ME  
KËRKESËN E SHOQËRISË “SPV BLUE 2” SH.P.K. PËR LICENCIM NË  
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2144/12 prot., datë 24.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “SPV BLUE 2” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2144 prot., datë 16.10.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaik “Blue 2”, me vendndodhje në Sheq Marinas, me kapacitet të instaluar 50 MW.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 229, datë 28.10.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 30.10.2024 dhe 31.10.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 02.12.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- ERE me shkresën nr. 2340 prot., datë 04.11.2024, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), për fillimin e procedurës ndërsa me shkresën me nr. 2144/3 prot., datë 05.11.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës

dhe i ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2144/4 prot., datë 13.11.2024, e-mailin e datës 04.12.2024 dhe shkresën me nr. 2144/5 prot., datë 06.12.2024, ka depozituar informacion/dokumentacion plotësues për aplikimin.
- Shoqëria “SPV BLUE 2” sh.p.k. gjatë mbledhjes së bordit të ERE datë 26.12.2024, ka bërë me dije se do të depozitojë dokumentacion për sa i përket fillimit të punimeve të parkut fotovoltaik brenda afatit të VNM-së paraprake. Në funksion të shqyrtimit të këtij dokumentacioni që do të depozitohet nga shoqëria, vlerësojmë që vendimmarrja e bordit të ERE të zgjatet me 10 (dhjetë) ditë, me qëllim shqyrtimin e këtij dokumentacioni.
- Në nenin 14, pika 3, parashikohet se: *Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të zgjasë deri në 10 (dhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Shoqëria brenda 5 (pesë) ditëve pune, duhet të depozitojë dokumentacion për sa i përket fillimit të punimeve të parkut fotovoltaik brenda afatit të VNM-së paraprake.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “SPV BLUE 2” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**